

VAKSINIMI NË PRAKTIKË

Kur ta vaksinohet fëmijën tim ?

Ta vaksinosh fëmijën që prej moshës 11 vjeçare, do të thotë të garantosh një efikasitet më të madh të vaksinës.

- midis 11 dhe 14 vjeç : vetëm dy doza janë të nevojshme ;
- midis 15 dhe 19 vjeç (rikuperim) : tre doza janë të nevojshme.

Mirë për ta ditur : përfitoni nga takimi vaksinal për përforcimin e dTcaP*, i parashikuar midis moshës 11 dhe 13 vjeçare, për të realizuar në të njëjtën kohë një nga dozat e vaksinës kundër HPV.

*Vaksina kundër difterisë (D), tetanozit (T), pertusis (Ca) dhe poliomyelitit (P).

Si ta vaksinohet fëmijën tim ?

Për vajzat si dhe për djemtë, unë i adresohem:

- një mjeku ;
- një farmacisti
- një mamie ;
- një infermiere ;
- një qendër vaksinimi të bashkisë apo të departamentit (pyesni pranë bashkisë suaj apo këshillit të departamentit).

Sa kushton vaksinimi kundër HPV ?

- Çdo dozë vaksine merret përsipër 65 % nga fondi i sigurimit shëndetësor. Pjesa tjetër në përgjithësi rimburohet nga siguracionet shtesë (siguracioni plotësues...).
- Vaksinimi mund të jetë falas në disa qendra vaksinimi të bashkisë apo të departamentit.
- Për personat të cilët kanë të drejtën e siguracionit Shëndetësor Plotësues Solidar (CSS) dhe të ndihmës mjekësore të shtetit, nuk kanë asgjë për të paguar.

NJË VAKSINIM I SIGURT DHE EFIKAS PËR TË MBROJTUR FËMIJËN TIM KUNDËR KANCEREVE HPV.

**FËMIJA JUAJ ËSHTË I SHKOLLUAR NË KLASËN E 5^{të},
ME AUTORIZIMIN TUAJ :**

- ai mund të vaksinohet në kolegji nga një profesionist shëndeti ;
- ai do të marrë dy doza vaksine, me një hapësirë kohore 6 muaj
- minimumi. Ju nuk keni asgjë për të paguar.

Deri më sot, më shumë se 100 milionë fëmijë dhe adoleshentë janë vaksinuar në rreth 80 shtete.

Për të ditur më shumë,
flisni me një profesionist shëndeti,
ose merrni takim në vaccination-hpv.e-cancer.fr



NUK I MBROJTMË KURRË TEPËR.

**VAKSINIMI KUNDËR
KANCEREVE HPV*,
për vajzat dhe për
djemtë nga moshë
11 vjeçare.**



UDHËZUES PRAKTIK

*HPV : Human Papillomavirus ose Papillomavirus Njerëzor.

INFORMOHEM MBI VAKSINIMIN KUNDËR KANCEREVE HPV

Përse ta vaksinoj fëmijën tim ?

Sot, vaksinimi kundër HPV parandalon deri në 90 % infeksionet HPV të cilët mund të provokojnë kancera.

Ai rekomandohet për vajzat dhe për djemtë kundër :

- leziona prekanceroze dhe/ose kancerat e qafës së mitrës, të vulvës, të vaginës dhe të anusit ;
- leziona beninje, por të dhimbshme, që dalin mbi lëkurë ose mukozat e anusit dhe të pjesëve gjenitale (lythat anogjenitale).

NJË VAKSINIM I SIGURT DHE EFIKAS

Që prej + se 10 vjet, + se 6 milionë doza janë dhënë në Francë, + se 300 milion në botë.

Një survejim ndërkombëtar i rreptë

Përdorimi i gjerë i vaksinave kundër HPV, survejimet e aplikuara në shumë vende dhe në nivel ndërkombëtar si dhe rezultatet e studimeve specifike kanë konfirmuar profilin e tyre të shkëlqyer të sigurisë, të njohur nga OBSH.

Kështu, për shembull, nuk është vërtetuar asnjë lidhje midis vaksinave dhe sëmundjeve auto-immune.

Efikasiteti i vaksinimit kundër HPV vërehet në vendet ku numri i të rinjve në moshë madhore të vaksinuar është i madh, si në Australi (rënie e kancereve dhe lezioneve prekanceroze të qafës së mitrës si dhe të lytheve anogjenitale tek meshkujt dhe tek femrat).

INFORMOHEM MBI PAPILOMAVIRUS NJERËZOR

HPV, çfarë janë?

HPV janë viruse njerëzore të quajtura papillomavirus. 80 % e femrave dhe e meshkujve janë ekspozuar ndaj këtyre viruseve gjatë jetës së tyre. Në përgjithësi, infeksionet HPV zhduken brenda disa muajve, por një pjesë e vogël mund të qëndrojnë dhe të kthehen në sëmundje.

Cila është lidhja midis viruseve HPV dhe kancereve ?

Ekzistojnë rreth 200 lloje HPV disa prej të cilave vijnë nga leziona prekanceroze dhe kanceroze. HPV janë gjithashtu përgjegjëse të lytheve anogjenitale.

Si transmetohen viruset HPV ?

Këto viruse transmetohen thjesht nga një kontakt me pjesët gjenitale, më shpesh gjatë marrëdhënieve seksuale, me ose pa penetrim.

ÇDO VIT NE FRANCË, 6 400 RASTE TË REJA KANCERI JANË SHKAKTUAR NGA PAPILOMAVIRUS NJERËZOR. Nëse kancerët HPV prekin femrat në pjesën më të madhe, më shumë se çereku prekin meshkujt.

Numri i sëmundjeve HPV- i shfaqur tek femrat dhe tek meshkujt në Francë në 2015 (sipas Shield dhe al., Hartwig dhe al., 2015).

	MESHKUJ	FEMRA
Kancer i penisit / Kancer i vulvës dhe i vaginës	100	200
Kancer i anusit	400	1 100
Kancer i orofaringut (goja, fyti...)	1 300	400
Kancer i qafës së mitrës	—	2 900
Leziona prekanceroze të vulvës, të vaginës, të anusit	130	rreth 2 500 deri në 3 000
Leziona prekanceroze të qafës së mitrës (CIN 2+)	—	rreth 30 000
Lythe anogjenitale	rreth 50 000	rreth 50 000